EUROPEAN CENTRE
FOR MINORITY
ISSUES KOSOVO

Udhëzimet për asistent ligjor

Raportimi, siguria dhe kontaktet

Working Towards a
Stable Multi-Ethnic Kosovo

AKIV

rrogrаek
Rrjeti i Organizatave të Grave Rome,Ashkali dhe Egiptase të Kosovës
The Network of Roma, Ashkali and Egyptian Women Organizations of Kosovo
E Kosovake Romane, Ashkaliengre thaj Egipqanengre Djuviengro Organisaciengri Kedin

TABELA E PËRMBAJTJES

I HYRJA 4

1.2 Roli i asistentëve ligjor 4

II METODAT E RAPORTIMIT 7

III SIGURIA 9

3.1 Siguria e asistentëve ligjor 9

3.2 Siguria e përfituesve 10

IV REFERIMI PËRFITUESVE 10

V KONTAKTET KRYESORE 12

Ferizaji dhe Fushë Kosova 13

Graçanicë dhe Mitrovicë(duke përfshirë Zveçanin, Zubin Potokun,Leposaviqin) 13

I HYRJA

Në Kosovë, gratë dhe vajzat që i takojnë grupeve minoritare, e veçanërisht Romëve, Ashkalive, Egjiptasve dhe Serbëve, ballafaqohen me pabarazi të vazhdueshme dhe të përhapur gjinore të përbërë nga margjinalizimi socioekonomik, politik dhe kulturor. Ndërkohë, prevalence e lartë e dhunës prek këto komunitete kjo thekson gjendjen e tyre veçanërisht të rrezikuar, ekzistojnë disa intervenime për të adresuar dhunën kundër grave të këtyre komuniteteve.

Projekti "Fuqizimi i komuniteteve minoritare në Kosovë kundër dhunës së bazuar në gjini" është një projekt dyvjeçar i finansuar nga Fodni i besimit i Kombeve të Bashkuara (KB) për të dhënë fund dhunës ndaj gruas. Ky projekt ka për qellim ti prek tre problemet kryesore me të cilat përballen komuniteti Romë, Ashkali, Egjiptas dhe Serb në Kosovë dhe kontribuon vulnerabilitetin e tyre ndaj DHBGJ. Së pari, të mbijetuarit minoritar nga DHBGJ ballafaqohen ne qasje të limituar të shërbimeve, si pasoj e pengesave linguistike, gjeografike, sociale dhe politike. Së dyti, gratë minoritare në Kosvë janë subject i ndjeshmërisë ekstreme socioekonomike, me shkallë të ulët të lartë të papunësisë, nivel të ulët të arsimimit dhe normë të lartë të analfabetizmit. Së treti, komunitetet pakicë, si meshkujt ashtu edhe femrat, shpesh ju mungon vetëdija për të drejtat e grave, barazi gjinore dhe mekanizmat kundër DHBGJ dhe regjistrohen norma të diskriminimit gjinor.

Për të adresuar tre problemet e përmendura lartë që janë thelb i shkaktimit të cenueshmërisë të grave minoritare ndaj DHBGJ, ECMI Kosovë propozon implementimin e tri strategjive në komunat e shënjestruara për të arritur ndryshime positive për gratë minoritare në këtë rajon. Së pari, projekti do të trajnoj, angazhoj dhe mbështet tetë (8) gra minoritare aktiviste lokale si asistente ligjore në bazë të komunitetit. Së dyti, projekti do të mundësoj në çdo nga katër lokacionet e shënjestruara trajnim të aftësive dhe stërvitje profesionale. Së treti, projekti parasheh organizimin e vazhdueshëm të aktiviteteve për ngritje të vetëdijës që synojnë mësuesit, studentët dhe udhëheqësit meshkuj, duke përfshirë organizimin e punëtorive për diskutim me meshkujt nga pakicat, dhe zhvillimin dhe implementimin e programit mësimor shkollor për të drejtat e grave.

Projekti do të implementohet në katër komuna në Kosovë dhe atë: Ferizaj,Graçanicë, Fushë Kosovë, Mitrovicë(duke përfshirë Zveçanin, Zubin Potokun, Leposaviqin.

Implementimi i këtij projekti bëhet përmes ECMI Kosovë dhe partnerët e saj në implementim janë: AKTIV, NRAEWOK, dhe CLARD të cilët do të jenë prezent në teren dhe do t'i ndihmojnë asistentëve ligjor në mënyra të ndryshme.

1.2 Roli i asistentëve ligjor

Asistentët ligjor janë personi i parë dhe më i rëndësishëm i kontaktit për gratë në komunat e caktuara pasi që ato do të bëjnë vizita nëpër shtëpi gjatë periudhës kohore njëzet e një (21) muajshe. Ato gjithashtu do t'i japin të mbijetuarve të DHBGJ këshilla dhe ndihmë për të pasur qasje ndaj shërbimeve për parandalim dhe trajtim në Kosovë duke siguruar që gratë e pakicave

nëkomunat e synuara janë më të afta dhe të gatshme për të pas qasje ndaj shërbimeve të parandalimit dhe trajtimit nga DHBGJ.

KUSH ËSHTË ASISTENITI LIGJOR ?[1]

Asistenti ligjor i bazuar në komunitet është person i cili:

- ✓ Ka njohuri themelore rreth ligjit, sistemit ligjor dhe procedurave të saj dhe ka aftësi bazike ligjore ;
- ✓ Është pjestar i komunitetit apo pjese e organizates e cila punon në komunitete dhe ka njohuri themelore për mënyra të qasjes të anëtareve të komunitetit ndaj shërbimeve juridike (duke përfshirë mekanizmat tradicional ose joformal të drejtësisë);
- ✓ Ka aftësi dhe njohur mbi mekanizmat alternativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, duke përfshirë ndërmjetësimin, zgjidhjen e konflikteve dhe negociatat
- ✓ Është në gjendje t'i komunikojë idetë dhe informacionet pjestarëve të komunitetit duke përdorur metoda interactive të mësimidhënjies
- ✓ Mund të ketë marrëdhëne të punës me autoritetet lokale dhe agjencitë për ofrim të shërbimeve
- ✓ Ka aftësi organizative të komunitetit që mund të përdoren për fuqizim të komuniteteve për të adresuar probleme sistematike vet në të ardhmen

Rolet dhe detyrat e asistentëve ligjor në këtë projekt janë qartë të përshkruara në kontratën e secilit asistent ligjor dhe përfshijnë këto:

- **Identifikimi i grave socio-ekonomikisht të cenuara nga pakicat,** kryesisht nga rajonet **rurale dhe të largëta,** si përfitues primar të projektit;
- **Identifikimi i meshkujve nga pakicat, udhëheqësit meshkuj, mësuesit e shkollave dhe studentët nga pakicat** si përfitues sekondar të projektit ;
- Të mbaj **takime koordinuese hyrëse dhe tjera joformale, së paku një herë në dy muaj,** me të gjithë akteret (duke përfshirë udhëheqësit e komuniteteve, përfaqësuesit e OJQ-ve, Policia e Kosovës, Qendra për punë sociale; dhe zyrtarët komunal për barazi gjinore);
- Të organizojë**dy takime formale koordinuese vjetore** ndërmjet të gjithë palëve të interesuara për të ndarë përvojat, për të diskutuar problemet dhe zhvilluar strategji të përbashkëta;
- Lehtëson **takimet tremujore të grave me udhëheqëset femra nga komuniteti** në komunen e tyre ;

[1]http://www.opensocietyfoundations.org/sites/default/files/paralegal-guide-20101208.pdf

- Të vendos **bashkëpunim të mirë** dhe **koordinim të afërt** me të gjithë instrumentet dhe mekanizmat lokale në dispozicion (Policia e Kosovës, Qendra për punë sociale dhe Shtëpitë e sigurta, Administratën komunale etj) dhe rregullisht të ftojës palët e tilla të interesuara për të vizituar komunitetin;
- **Propozon selektimin e shkollave të mesme** me numër të konsiderueshëm të nxënësve pakica në komunat e synuara;
- Të bëj **aktivitete për rritje të vetëdijes** siç specifikohet në projekt;
- **Të reklamojë programin e trajnimit të aftësive** të implementohet në komunitetin relevant;
- **Rregullisht monitoron** dhe të jetë person kontaktues për sesionet e trajnimit të aftësive dhe të përdorë mundësinë për t'i angazhuar pjesëmarrësit në diskutime për DHBGJ, posaçërisht për dhunën në familje dhe martesat e hershme dhe të detyruara;
- **Të asistojë konsulentëve** duke ofruar ndihmen përfituesve në procesin e aplikimit për grantet/kredite ;
- Të kryej **vizita në shtëpi** (minimum **12 vizita në muaj gjatë 15 muajve të parë**të angazhimit si asistent ligjor) në komunitete dhe të bisedojë me gratë dhe të themeloj një marrëdhënie të bazuar në besim);
- Të kryej **vizita pasuese të grave** të cilat asistentët ligjor konsiderojnë të jenë veçanërisht të rrezikuara nga DHBGJ gjatë gjashtë muajve të fundit;
- Të sigurojë atyrë që kanë përjetuar DHBGJ **asistencë për qasje të shërbimeve në dispozicion për parandalim dhe trajtim në Kosovë (**p.sh Policia e Kosovës, avokati i viktimes, shtëpi të shendetit, Policia e Kosovës, qendra për punë sociale, strehimoret, komisionin për ndihmë ligjore). Kjo mund të përfshijë nga referenca, sigurimi i transportit deri tek shoqërimi i përfituesit tek ofruesit e shërbimeve;
- **Të ofroj mbështetje të menjëhershme**: këshillimi, ndërmjetësimi, ndihmë në hartimin e kërkesave për urdhër mbrojtje;
- Të ofroj grave minoritare **me këshillë bazike ligjore për pronë, punësim dhe çështje tjera civile; mbështetje në marrjen e dokumenteve personale**;
- Ofrim i ndihmës në qasje ndaj mbështetjes ligjore profesionale që mund ta ketë në dispozicion përmes OJQ-ve për ndihmë ligjore, Komisionit të ndihmes ligjore dhe avokatëve të viktimave, duke përfshirë ndihmen në procedurat e divorcit dhe kujdestarisë së fëmijës;
- Mbështetje e grave gjatë**aplikimit për shërbimet sociale** (p.sh ndihmë sociale, penzion, shtesat për fëmijë).;
- Të veprojë si **ndërmjetësues** dhe të**avokoj për grat minoritare** brenda komunitetit të tyre;
- Të organizojë**punëtorit për diskutime** me meshkujt minoritar;
- Merrë pjesë në takime **për rishiqim afatmesëm** dhe takime **të rishiqimit në fund të projektit**;
- Të veprojë si **person kontaktues** për të gjitha aktivitetet e projektit në komunitetin e saj;
- Plotëson **formen e raportimit** për secilin takim/diskutim me përfituesit;
- Dorëzon **raportet e shkruara** (duke përfshirë format e raportimit) në ECMI Kosovë në baza mujore.

II METODAT E RAPORTIMIT

Tema me të cilën do të merremi me anë të këtij projekti, pra dhuna e bazuar në gjini dhe dhuna familjare, është një temë shumë e ndjeshme dhe gratë që ne do të vizitojmë janë në një gjendje të ndjeshme. Prandaj, të gjithë masat paraprake duhet të ndërmirren për të siguruar se gratë që do të vizitojmë:

- ✓ Ndjehen të sigurta duke folur me ne;
- ✓ Na besojnë dhe janë në gjendje të ndajnë informata të ndjeshme me në;
- ✓ Identiteti i tyre është i mbrojtur në mënyrë rigoroze ;
- ✓ Ato mbështeten dhe i besojnë këshillave tona dhe referimeve.

Për këtë qëllm ECMI Kosova ka zhvilluar një metodë strikte të raportimit të cilën ju do të duhej ta implementoni gjatë punës tuaj në këtë projekt.

Principet themelore të raportimit janë:

- Ju duhet të**përgatisni raportin pas çdo vizite në shtëpi** që do të kryeni gjatë periudhës njëzet e një mujore dhe të gjithë raportet duhet të janë në**format elektronik** të dhënë nga ECMI Kosovë;
- Të gjithë raportet duhet të ruhen në një**dosje të sigurt në kompjuter** dhe çdo dokument duhet të **mbrohet me fjalkalim** dhe sapo ju të dërgoni raportet në ECMI Kosovë ju duhet t'i fshini ato;
- Raportet dërgohen tek Huseinovic-Veliu dhe Pollozhani dhe duhet pastaj të**fshihen** nga llogaria juaj në email dhe dosja juaj.
- Përndryshe ju mund të ruani të gjitha dokumentet në**USB tuaj personale**, megjithatë ju duhet të keni kujdes të tepërt **që nuk do të humbni apo harroni USB-në** dhe se të gjithë dokumentet janë të**mbrojtura me fjalkalim**;
- **Emrat e grave** të cilat vizitojnë asistentët ligjore janë**rreptësisht konfidenciale,** dhe për këtë arsye për raportim çdo grua do ta ketë**numër të caktuar** i cili do të futet në raport. Çdo asistent ligjor do të bëj një list me numra dhe emra dhe kjo list duhet të jetë e ndarë nga raporti. **Në raport mund të përmenden vetëm numrat,** emrat kurrë, madje as emri i bashkëshortit, fëmiut apo fqinjit.

> **Shembulli 1:**
> **Jane Doe- F043 (kjo është informata nëlisten tuaj të emrave dhe numrave** dhe JO në raport **)**
>
> Sot kam vizituar #043 në shtëpin e saj dhe kemi biseduar lidhur me problemet me të cilat ballafaqohen fëmijët e saj në shkollë.

- Për të shmanguar dyfishimin e përfituesve, çdo asistent ligjor do të ketë të caktuar lagjet për të vizituar. Një asistent ligjor do të përdor vetëm numrat tek dhe tjetri asistent ligjor do të përdor madje numra. Ju lutem të shiqoni në kutinë më poshtë e cila shpjegon se si të numrohen përfituesit:

Numrimi i përfituesve

Numri i secilit përfitues duhet të paraprihet nga shkronja e parë e çdo komune, siç është treguar më poshtë:

- **Ferizaj:**

  Asistent ligjor 1: F01, F03, F05,….. F23…..
  Asistent ligjor 2: F02, F04, F06,……F24…..

- **Graçanicë**:

  Asistent ligjor 1: G01, G03, G05,….. G23…..
  Asistent ligjor 2: G02, G04, G06,……G24…..

- **Fushë Kosovë :**

  Asistent ligjor 1: FK01, FK03, FK05,….. FK23…..
  Asistent ligjor 2: FK02, FK04, FK06,…… FK24…..

- **Mitrovicë:**

  Asistent ligjor 1: M01, M03, M05,….. M23…..
  Asistent ligjor 2: M02, M04, M06,……M24…..

- **Zveçan:**

  Asistent ligjor 1: Z01, Z03, Z05,….. Z23…..
  Asistent ligjor 2: Z02, Z04, Z06,…Z24…..

- **Zubin Potok:**

  Asistent ligjor 1: ZP01, ZP03, ZP05,….. ZP23…..
  Asistent ligjor 2: ZP02, ZP04, ZP06,…ZP24…..

- **Leposaviq:**

  Asistent ligjor 1: L01, L03, L05,…..L23…..
  Asistent ligjor 2: L02, L04, L06,…L24…..

- Lista e grave dhe numrat e tyre përkatës do të mbahen nga asistenti ligjor në**një vend të sigurt**, dhe kurrë nuk duhet të lihet në zyre ku punojnë asistentët ligjor. Lista e numrave **nuk**

duhet kurrëtë jetë në vendin e njejtë ku mbahen raportet. Vetëm ECMI Kosovë e ka listen e të gjitha grave të vizituara dhe listën përfundimtare të numrave. Nëse ju përdorni USB, **lista e numrave nuk duhet të jetë në të njejtin USB sikur raportet.** Lista e numrave dhe emrave duhet poashtu të jetë e **mbrojtur me fjalëkalim** dhe lista përfundimtare duhet të jetë**në posedim vetën nga ECMI Kosova.**

- Ju do të jepni **kpjen e vetme** të raportit ECMI Kosovës **çdo muaj** dhe **pastaj do t'i fshini të dhënat nga kompjuteri dhe/apo USB juaj.**
- Në qoftë se nuk jeni të sigurt për numrin dhe emrin e pjesëmarrësve ju mund të kontaktoni ECMI Kosova, por duhet të siguroni se **çdo komunikim lidhur me numrin dhe emrin duhet të fshihet** nga llogaria juaj sapo është marrë informacioni.
- Asistentët ligjor duhet poashtu **të dorëzojnë raportin mujor** ku ata përshkruajnë**aktivitetet** e tyre në rajonin e tyre të synuar. Vini re se në raportin mujor, nëse përmendet ndonjë vizitë në shtëpi, gruaja duhet të referohet me anë të numrit të saj. Forma për raportin mujor do t'ju sigurohet nga ECMI Kosova.
- **Emrat** e përfituesve **munden vetëm** të përmenden në**raportin** mujor **nëse përfituesi ka kontaktuar një avokat dhe ka bërë një ankesë,** në të cilin rast nga ju do të kërkohet emri, por **mos e vendoni** numrin. **Numri dhe emri i përfituesit nuk duhet kurrë të paraqiten në të njëjtin dokument.**

III SIGURIA

Siguria e asistentëve ligjor dhe përfituesve është shumë e rëndësishme për këtë projekt. Ne do të përpiqemi të sigurojmë të gjitha masat e nevojshme janë marrë paraprakisht kështu që asistentët ligjor dhe përfituesit të ndihen të sigurt dhe se askush nuk duhet të dëmtohet në asnjë mënyrë. Për këtë arsye, ECMI Kosova do të vendosë kontakte të drejtpërdrejta në mes të zyrtarëve të Policisë së Kosovës dhe çdo asistenti ligjor. Zyrtarët e Policisë së Kosovës do të jenë në dijeni për këtë projekt, për atë se kush janë asistentët ligjor dhe për lagjet ku ata do të punojnë. Për më tepër, asistentët ligjor mund të kontaktojnë këta zyrtarë direkt sa herë që ata ndihen në rrezik ose në qoftë se ata dëshirojnë të raportojnë drejtpërsëdrejti ndonjë rast në polici. Asistentët ligjor do të kanë kontakte poashtu edhe në komunë e cila do të njoftohet nga afër me projekt.

3.1 Siguria e asistentëve ligjor

- ✓ Në rast se asistenti ligjor nuk ndjehet i sigurt në një shtëpi, ai duhet të largohet menjëherë nga shtëpia.
- ✓ Në qoftë se ata kanë arsye të besojnë se rreziku vazhdon, ose në qoftë se ata ishin kërcënuar ata duhet të kontaktojnë zyrtarin e caktuar të Policisë menjëherë.
- ✓ Asistentët ligjor poashtu të raportojnë rastin tek një staf nga ECMI Kosova dhe organizaten partnere përgjegjëse në komunen tuaj.

3.2 Siguria e përfituesve

- ✓ Në rast se asistenti ligjor mendon që pasi ai ta lëshojë shtëpinë në të cilen ishin se përfituesi mund të jetë në rrezik, ata duhet të kontaktojnë zyrtarin e caktuar të Policisë.
- ✓ Nëse gjatë bisedimit me përfituesin pala e tretë hyn në dhomë/hapsiren, asistenti ligjor duhet ta ndryshojë temën menjëherë.
- ✓ Asistenti ligjor duhet të sigurohet se ajo bisedon me përfituesit vetëm kur ata janë vetëm në shtëpi apo kur e shohin se përfituesi ndjehet rehat për të folur me ta. Nëse asistenti ligjor vëren se përfituesi nuk ndjehet rehat, atëherë asistenti ligjor mundet ose të ndryshojë temën e diskutimit, apo të largohet.
- ✓ Nëse ju besoni se përfituesi ka qenë viktim e dhunës në familje ju duhet ata t'i referoni tek institucionet e duhura. Ju lutem të konsultoheni me kapitullin IV për më shumë detaje.

IV REFERIMI PËRFITUESVE

Njëri nga shumë rolet e asistentëve ligjor është t'i ndihmojë përfituesve të kenë qasje ndaj shërbimeve sociale, parandaluese dhe shërbimeve trajtuese. Asistentët ligjor duhet të jenë të informuar për të gjithë shërbimet në dispozicion në komunë dhe ku përfituesit mund të kërkojnë ndihmë apo këshillë. ECMI Kosova ka përgatitur një list të disa kontakteve për çdo komunë. Lista nuk është e përfunduar, asistentët ligjor duhet të mbledhin më shumë kontakte gjatë punës së tyre, si shtesë edhe organizatat e përfshira do të ofrojnë të dhëna të reja asistentëve ligjor për më shumë kontakte:

- **Ferizaj:**
    - **Njesia regjionale e Policisë së Kosovës kundër dhunës në familje:**
      Rr. Driton Islami
      dhunafamiljare@hotmail.com
      03850801194
    - **Qendra për punë sociale**
      Rr. Vellezerit Gervalla
      qpferizaj@gmail.com
      0290327525
    - **Zyrtar për avokim të viktimave:**
      Rr. Sejdi Sejdiu
      vaau_advocates@yahoo.com
      0290325602
    - **Strehimore (e mbuluar nga Gjilani):**
      Liriagjilan10@hotmail.com
      044125729
      Linja ndihmëse 24 orë: 0280325700
    - **Qendra për mbrojtje të grave dhe fëmive:**
      Naime Sherifi
      044 508 081

038 545 476

- **Graçanicë**:

  - **Njesia regjionale e Policisë së Kosovës kundër dhunës në familje:**
    Stacioni policor numër 2 (në Prishtinë) Rr. Mahalla e Muhaxhereve
    Fiksi 92
    Celulari 192
  - **Qendra për punë sociale:**
    Llapje Selle (afër spitalit)
    049776700
  - **Ruka ruci:**
    Nevenka Rikalo
    rikalonevenka@yahoo.com
    044-839 986
  - **Zyrtar për avokim të viktimave:**
    Ndërtesa e gjyqit të qarkut , kati i katërt, rr. Ilir Konushevci
    vaau_advocates@yahoo.com
    038246059
    044278738
  - **Strehimore:**
    E mbuluar kryesisht nga Prishtina qendër
    cpwcprishtina@yahoo.com
    044508081
    038545476

- **Fushë Kosovë:**

  - **Njesia regjionale e Policisë së Kosovës kundër dhunës në familje:**
    Stacioni policor numër 2 (në Prishtinë) Rr. Mahalla e Muhaxhereve
    Fiksi 92
    Celulari 192
  - **Qendra për punë sociale:**
    Rr. Nena Tereze
    038536462
  - **Zyrtar për avokim të viktimave:**
    Ndërtesa e gjyqit të qarkut, kati i katërt, rr. Ilir Konushevci
    vaau_advocates@yahoo.com
    038246059
    044278738
  - **Qendra për mbrojtje të grave dhe fëmijëve:**
    Naime Sherifi
    044 508 081
    038 545 476
  - **Strehimore:**

Mbuluar kryesisht nga Prishtina qendra
cpwcprishtina@yahoo.com
044508081
038545476

- **Mitrovicë (duke përfshirëZveçanin, Zubin Potokun, Leposaviqin)**

  - **ia regjionale e Policisë së Kosovës kundër dhunës në familje:**
    Drejtorati regjional i policisë së Kosovës Mitrovicë/ rr. Sheshi Agim Hajziri
    Fiksi 92
    Celulari 192
  - **Qendra për punë sociale:**
    Str. Dositej Obradovic
    02882977
  - **Zyrtar për avokim të viktimave:**
    Mbuluar nga Mitrovica dhe për të gjithë komunat: Ndërtesa e stacionit policor jugor
    vaau_advocates@yahoo.com
    028534489
    044310466
  - **Strehimore:**
    cpwcmitrovica@yahoo.com
    028534351
    044158686

V KONTAKTET KRYESORE

Kontaktet kryesore për asistentët ligjor, veçanërisht lidhur me pyetjet për projektin dhe pytjet e përgjithshme janë stafi i **ECMI Kosovë.** Kontaktet e ECMI Kosovë janë relevante për të gjithë asistentët ligjor.

Nora Huseinovic-Veliu	**Lura Pollozhani**
Menaxhere e projektit	Asistente e projektit
info@ecmikosova.org	info@ecmikosova.org
049-861-945	044-395-882
+381 (0) 38 224 473	+381 (0) 38 224 473
ecmikosova.org	

CLARD Kosova do të ofrojë ndihmë teknike të gjithë asistentëve ligjor, edhe për çështjet e lidhura me procedurat ligjore dhe institucionale asistentët ligjor duhet të kontaktojnëzyrtarët e caktuar nga CLARD-i. Ju lutem vini re se orari i punës në CLARD është në mes 08.00- 16.00.

Arbane Shala
Këshilltare teknike
arbane@clardkosovo.org
+381 (0) 38 223 795

Nenad Trajkovic
Këshilltar teknik
trajkovic@clardkosovo.org
+381 (0) 38 223795

www.clardkosovo.org

Përveç mbikëqyrjes dhe udhëzimeve të ofruara nga ECMI Kosova dhe CLARD Kosova, secili asistent ligjor do ta ketë organizaten e cila do të jetë përgjegjëse për mbikëqyrje në komunën e tyre. Kjo do të bëhet nga AKTIV dhe NRAEWOK të cilët do të jenë aty për të mbikëqyrur dhe dhënë këshilla asistentëve ligjor. Përgjegjësitë e këtyre organizatave janë të ndara nga komuna.

Ferizaji dhe Fushë Kosova

Organizata kontaktuese për asistentët ligjor që punojnë në komunat e Ferizajit dhe Fushë Kosovës është Rrjeti i Organizatave tw grave rome, ashkali dhe egjiptase në Kosovë (NRAEWOK). Personat kontaktues të kësaj organizate janë:

Shpresa Agushi
Drejtor ekzekutiv

+381 (0) 38 733 265

Mimoza Gavrani
Koordinator
mimo_za_g@hotmail.com
+381 (0) 38 733 265

Graçanicë dhe Mitrovicë(duke përfshirë Zveçanin, Zubin Potokun,Leposaviqin)

Organizata kontaktuese për asistentët ligjor që punojnë në komunen e Graçanicës dhe Mitrovicës (duke përfshirëZveçanin, Zubin Potokun,Leposaviqin)është OJQ-ja Aktiv. Personi kontaktues në këtë organizat është:

Caleb Waugh
Këshilltar teknik
caleb.ëaugh@ngoaktiv.org
+381 65 5572190

SHËNIM: Të gjithë asistentët ligjor në**komunikimin e tyre lidhur me raportet** dhe çdo informacion tjetër që ka të bëjë me përfituesit, **duhet të kontaktohet personi kontaktues i ECMI Kosovë**dhe organizata partnere e cila është përgjegjëse për komunen e tyre. Nëse asistenti ligjor nuk është i sigurt kush duhet të kontaktohet, ata duhet t'i referohen stafit të ECMI Kosova i cili do t'i udhëzojë tek personi kontaktues përkatës.

ECMI Kosovë
Rr. Nëna Terezë Nr. 41, banesa. 29
10000 Prishtinë, Kosovë
Tel. +381 (0) 38 224 473

Rr. Cika Jovina Nr. 3, kati parë
38220 Mitrovicë , Kosovë
Tel. +381 (0) 64 00 55 488

Email:info@ecmikosova.org
ëeb:ecmikosova.org



